



KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

U R D H Ë R

Nr.11, datë 11.3.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.5 DATË 26.2.2020 TË MINISTRIT
TË SHTETIT PËR DIASPORËN, PËR “MIRATIMIN E ANËTARËVE TË
KËSHILLIT KOORDINUES TË QENDRËS SË STUDIMEVE DHE
PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT”**

Në mbështetje pikes 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikës ë), të nenit 5, ligjit nr. 16/2018, datë 05.04.2018, “Për diasporën”, të pikave 8, 9, 10 dhe 11 të Vendimit Nr. 601, 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”, me propozim të Akademisë së Shkencave Nr. 561/1 Prot, datë 29.10.2020,

URDHËROJ:

Në pikën 1 të Urdhrit Nr. 5, datë 26.2.2020, të Ministrit të Shtetit për Diasporën, bëhet ndryshimi
sim ë poshtë vijon:

1. Z. Gjovalin Shkurtaç, anëtar, zëvendësohet për pjesën e mbetur të mandatit nga z. Pëllumb Xhufi, anëtar, si përfaqësues i Akademisë së Shkencave.
2. Ngarkohet Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët për zbatimin e këtij

Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PANDELI MAJKO
MINISTËR